



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
MINISTRI

Nr prot 2751

URDHËR

Nr. 105 Datë 09.05. 2017

PËR

**SHPALLJEN E “THIRRJES SË TRETË” NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR
TË PRAKTIKAVE TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike” të ndryshuar,

Urdhëroj:

1. Shpalljen e “Thirrjes së tretë” në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës me mbështetjen e administratës shtetërore, institucioneve të pavarur, njësitë e qeverisjes vendore si dhe biznesit, brenda muajit qershor 2017.
2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhëri.
3. Drejtoria e Koordinimit të Politikave Rinore në Ministri si Shërbimi Kombëtar për Rininë të bëjnë koordinimin e programit me institucionet që paraqesin interes dhe biznesin.
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Sociale dhe Drejtoria e Koordinimit të Politikave Rinore në Ministri si dhe Shërbimi Kombëtar për Rininë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



